



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL NGA SEANCA E IX E RREGULLT e KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Seancën e ftoi dhe e kryesoi kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, z.Naim Pira. Seanca është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, në Shtëpinë e Kulturës “Gursel e Bajram Sylejmani” në Viti, më 19.10.2015 (e hënë) në ora 10⁰⁰. Në seancë prezantuan 25 anëtarë të Kuvendit. Në seancë ishin prezent, nënkryetari i Komunës z.Hasan Aliu, drejtorët e Drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, zyra ligjore, organizata joqeveritare dhe mediat e shkruara dhe elektronike.

Kryesuesi para se të filloj me punë sipas rendit të ditës i përshëndeti të gjithë të pranishmit, si Nënkryetarin e Komunës, Këshilltarët e Kuvendit, Drejtorët e Drejtorive, Përfaqësuesin e OSBE-së, OJQ-të, Mediat etj. Pas numërimit nga sekretaria të këshilltarëve në sallë kryesuesi konstatoi se kemi kuorum dhe mundemi me filluar me punë të seancës së IX të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë.

Kryesuesi: Para se të kalojmë në miratimin e rendit të ditës kisha lut këshilltarët a ka kush ndonjë pyetje apo ndonjë propozim, fjala është për ju:

z.Sejdi Emini: Një pyetje për drejtorin e Arsimit, po bahen dy muaj dhe ende nuk ka kontrata të punëtorëve të Arsimit, duke ditë qysh munden me punu punëtorët pa kontrata. Nëpër shumë komuna tjera, dikund nja dy javë hapësirë jepet të bahen kontratat, po kjo është një çështje bukur e ndishme se punëtorët nuk e ndijn veten rahat. Tash u bënen dy muaj, kontratat duhet me i pas, nuk mundemi me punu na pa kontrata, shkollën ku punoj unë nuk është asnjë kontratë, prandaj nuk e di ku është problemi, a është çështje politike apo ndonjë problem tjetër, kisha dashtë një përgjigje nga drejtori. Tjetra, është fol edhe ma herët për ato makinat e famshme të mjelësve të lopëve, unë kam qenë personalisht dje në fshatin Debellde, i kam vizitu dy shtëpi, ku njëra nga ato shtëpi kishte dikund 25 krerë lopë dhe i kishte 15 krerë qumështore dhe nuk e kish gëzuar të drejtën me marr atë makinë dhe bukur ishte e shqetësuar, ky ishte Fekir Ramadani, dhe e vizitua një shtëpi tjetër Mehmet Rrahmani dhe ai kishte 8 krerë lopë dhe që të vetmin burim të mbijetesës kishte atë dhe nuk e kanë gëzu atë të drejtë. Unë nuk mundem me kuptuar, ju kisha lut me të vërtetë të keni parime, le ta gëzojnë atë të drejtë ata njerëz që e meritojnë sepse ata atë burim të jetës e kishin, drejtor është mirë që personalisht me shkuar me i vizituar dhe mos me i lënë anash ato familje.

znj.Mirlinda Sadiku: Pasi që te shkolle e mesme, rruga “Flaka e Janarit” ka pasur më herët zebra, mirëpo për shkak kualitetit ose të ngjyrës, ngjyra është avulluar, është hekë shumë shpejtë, do të kisha pasur kërkesë për drejtorin e Shërbimeve Publike, që ta kesh parasysh sepse aty është një fluks i madh i nxënësve, po ashtu vijnë edhe kombibusat, autobusat dhe

shpesh herë krijohet një tollovi shumë e madhe. Mos prisni që të na ndodh ndonjë rast, mos dhashtë Zoti ndonjë fëmijë të pësojë, sepse atëherë kjo është e dhembshme, pra të bëjmë një parandalim, po ashtu edhe te stacioni i autobusëve. Një pyetje tjetër e kam në lidhje me Lagjen e “Shaqirëve” të fshatit Dëbellde, sipas një informate të publikuar nga Vitilive thuhet se ka pasur rrëshqitje të dheut, më intereson ta di drejtor a është evituar kjo, domethënë a ka qasje në rrugë kjo lagje e “Shaqirëve”.

z.Bekim Azizi: Unë si zakonisht po filloj me dy kërkesat që i kam, është seanca e 9 që kërkoj listën e subvencioneve nga kryetari për vitin 2014, për ndihma momentale mbi 100 mijë euro që ka dhënë, atë jam duke e kërkuar që një kohë të gjatë, nuk është te sjell, sepse aty dyshohet se ka shkelje të rënda. Kërkoj edhe një dokument me të cilin mjetet e zotuar të kanalizimit të Smirës dhe të Tërpezës janë bartur për projekte të tjera, kur mjetet e zotuar nuk lejohen me ligj të barten, kërkoj vetëm vendimin me shkrim, unë këto i përsëriti si kërkesa dhe qo ti përsëriti deri sa ti marrë, kam edhe dy pyetje kimi marrë një vendim për dislokimin e tregut të kafshëve ku është procesi që nuk është bërë dislokimi pse nuk është përgatitur vendi, edhe një pyetje tjetër në shkollën e mesme profesionale nuk ka rrymë ku është problemi me punua gjitha drejtimet teknike edhe mos me pas as rrymë në shkollë, qa jeni duke ndërmarrë për këtë çështje a do të lëshohet ma shpejt.

z.Bislim Bislimaj: Të nderuar koleg dhe ju gjithë të pranishëm, ju drejtohem me një kërkesë që me një pikë të rendit të ditës të futet situata aktuale politike në komunë dhe Kosovë, duke ditur se ngjarjet të cilat po i përjetojmë janë breng e të gjithë qytetarëve, mendoj se një analizë dhe në fund një deklaram i këtij kuvendi në lidhje me to do të ishte një nderim në nderin tonë si qytetarë se nuk mund të rrimë indeferent ndaj këtyre ngjarjeve sa të pahijshme aq fyese nëpër të cilat po kalon shoqëria jonë. Lëvizja Vetëvendosje ka iniciuar bashkë me partitë opozitare një peticion në lidhje me tërheqjen e nënshkrimit mbi marrëveshjen e Zajednicës, dhe mos luajtjes së kufirit nga ana e Malit të Zi, nga përvoja e komunës sonë në të kaluarën kur neve na i cenoi kufijtë Maqedonia gjithë populli i Kosovës u vu në mbrojtje të këtyre kufijve, ju kujtohet se në fshatin Dëbellde nuk ka ardhur vetëm kryetari i komunës të atëherëshme po kanë ardhur edhe partitë tjera opozitare, bile edhe lideri i Vetëvendosjes z.Albin Kurti ka qenë prezent në protestat e asaj kohe dhe atëherë nuk kemi pasur dallime për çështje esenciale, sot ne nuk po e shohim të arsyeshme që në këtë pikëpamje të vetëm se një subjekt ose disa subjekte politike kanë marrë një iniciativë për me tërhequr diçka që neve po na brengos edhe po na dëmton, nënshkrimi po shkon mirë po nënshkruhen njëjtë sikur atëherë anëtarët e të gjitha subjekteve, gjithashtu do të marrim qëndrim nga sulmet që po i bëjnë pushteti ndaj aktivistëve të opozitës e sidomos të atyre të Vetëvendosjes si pasojë e të cilave po dergjen nëpër burgje për shkak se po e mbrojnë të drejtën themelore të njeriut për të shprehur mendimin e lirë. Ne e dimë ngjarjen, është ndal lideri i Vetëvendosjes pa urdhër arrest, një njeri që ka imunitet të Kuvendit është ndalur pa kurrfarë arsye nga policet që e kanë kryer një kurs 6-mujor dhe nënshtrohet para njerëzve para botës edhe para kamerave ky është turp.

Kryesuesi: Unë konsideroj se misioni i këshilltareve komunal në nivelin lokal është mirë të merret me problematikat e komunës, problematikat e nivelit qendrorë dhe politika qendrore konsideroj që bëhen në Parlamentin e Kosovës dhe fatmirësisht ne po edhe ju si Lëvizje Vetëvendosje keni përfaqësuesin e juaj në Kuvend të Kosovës dhe ai do ti artikuloj propozimet kërkesat e qytetarëve në nivelin qendrorë, ne jemi këtu të merrmi me atë lokal.

z.Hasan Aliu: Më lejoni që pyetjet të cilat janë të parashtruara në veçanti për drejtorat ata do të përgjigjen vetë, unë do të ndalem te këshilltari i Vetëvendosjes Sejdi Emiri, i cili po më vjen shumë mirë që ke bërë një vizitë nëpër Dëbellde edhe nëpër lokalitet të tjera, se është një ndihmesë edhe e qeverisë komunale që e ushtrojnë pushtetin, megjithatë unë nuk dua ta

kontestoj atë të cilën ti e thua se ishin dy fermerë me kaç krerë dhe janë persona të cilët e meritojnë, ne kurrë nuk kemi thanë se të gjithë ata të cilët i kanë plotësua kushtet kemi pas mundësi financiare mi mbulu me ato makina, por vitin e kaluar u kanë numri kaç sa i kanë marrë këtë vite do të jetë edhe një numër bukur i madh dhe vazhdimisht do të bie ai numër dhe një ditë edhe ata do ta marrin pasi i plotësojnë kushtet, por numri i kërkesave në përputhje me fuqinë financiare është shumë ma i madh, prandaj është komisioni, do të bëhen verifikime, është me rëndësi që ata të cilët i marrin edhe ata ti plotësojnë kushtet. Këshilltarja Mirlinda e parashtrori një pyetje, jemi ka punojmë në atë drejtim, është e vërtetë materiali është ai që është dhe ka nevojë për ato zebra, është edhe një grup i mobilitetit në bashkëpunim me punëtorët e komunës, me DEMOS-in, janë ka punojmë në këtë drejtim dhe besoj se së shpejti do të kryhen edhe ato punë, ndërsa te lagjja e “shaqirëve”, unë e di se është pastru, Bekimi në vazhdimësi i ka kërkuar, veç kisha me të thanë një çështje, pyetjen e dytë që e shtrove ti sikur ke dashtë mi ik asaj, se ti ke qenë me një takim i ftuar një takim që e quajnë takim i progresit, që kanë qenë të ftuar edhe kryetari i këshillit të fshatit, kanë qenë të gjithë këshilltarët e kuvendit komunal që vinë nga ai lokalitet dhe kam pyet me emër, ti nuk ke qenë, sikur ti të ishe shumë i interesuar për atë çështje për mos me bë ku me ditë sa publike, se nuk ka nevojë me bë është problemi me ditë esencën edhe mi ditë edhe të gjitha të metat edhe të kanalizimit në Smirë, ti ke mungu. Pyetjen tjetër që e shtron, vendimin për dislokimin e tregut, ju e dini se financues të palestrës sportive është ministria e MKRS-së dhe momentin kur ata e kanë shpall tenderin ne na u ka dashtë një vendim i tillë, jemi ka punojmë në atë drejtim, është ka bëhet shtruarja e rrugës me zhavorr prej tregut të gjelbërt deri në tregun e kafshëve dhe besoj se kur mbërrim me punë ajo çështje do të kryhet. Shkolla mesme nuk ka rrym, e dimë edhe ne e dini se financues ka qenë ministria, ne jemi duke bërë trysni të vazhdueshme që rryma sa ma shpejt të lëshohet. Bislimi atë që e ngriti, unë mendoj si kryesuesi, besoj se kjo temë është e nivelit qendror, gjendja shqetësuese politike është për të gjithë, por megjithatë ne si kuvend komunal nuk jemi të thirrur me debatua për çështje të tilla. Vetëm një po të informoj se the për Debëllde, Albin Kurti nuk ka qenë në atë protestë.

z.Qahil Sinani: Po më vjen mirë se sot po flitet për kontratat, që 15 vite nuk është fol për kontratat, po ju njoftoj se do të kryhen edhe këto, po janë mbi 800 punëtorë dhe kërkohet një punë ma e madhe, do të bisedohet me drejtor të shkollave, prandaj është vazhdimësi, kryhen kontratat punëtorët nuk mbesin keq, ati punëtori që ju lëshohet kontrata për 10 orë ma nuk ka të drejtë të merre orë shtesë për klasor, mundemi me krye menjëherë, ndërsa për ata lëndor lëshohet kontrata për 15 orë, i humbin 10, vetëm për 5 orë paguhet. Nëse e këqyrim në realitet nuk është shumë e kënaqshme, prandaj nuk është bash e favorshme kontrata e përhershme, ngase kurrë nuk ju ka shpall vendi askujt, problemi kryesor ka qenë këtë vit sistemimi edhe është krye me sukses, ju po shkruani nëpër gazeta, por asnjë punëtor i arsimit nuk ka mbetur jashtë sistemit edhe nuk e di qa janë juve të ju mundu, kanë marrë tepër, por nuk kam marrë prej Beogradi kam marrë të këtuhit. 26 punëtorë të teknikës kanë pasur me mbet pa punë, kemi rreziku dhe i kemi mbajtur edhe kanë mbet edhe këta tjerët që kanë hy janë në sistem. Te shkolla teknike për rrymë: A e kanë bë me interes të veçantë kompanitë që e kanë marrë shkollën për me marrë pare ma shumë se 2 milion që nuk kemi qasje Komuna e Vitisë, se e kanë paraparë një trafo 250 kw, çka nuk është për atë shkollë, prandaj kemi mbet me shku në Ministrinë e Arsimit, në Drejtorinë për Infrastrukturë me marrë projektin edhe me shikua.

z.Nexhmedin Jakupi: Është e vërtetë që gjatë këtij viti kemi pasur shembje të dheut në kilometrin e parë të rrugës që shpie për në lagjen e “shaqirëve”, na gjatë këtij viti tri herë kemi intervenu në atë pjesë të rrugës, për momentin rruga është e kalueshme, ne po bëjmë përpjekje dhe po bëjmë analiza sa a kemi mundësi që me kompaninë që e kemi të kontraktuar

për mirëmbajtjen e rrugëve ta zgjidhim këtë problem, për zebat u përgjigje nënkryetari po planifikojmë aty me planin e mobilitetit nëse na jepet mundësia do e krym shumë shpejtë.

z.Bekim Azizi: Dola vetëm të replikoj pak me nënkryetarin, se unë jam duke e lyp vendimin, që mjetet e zotuar të kanalizimit të Smirës dhe Tërpezës janë bartur për projekte tjera. Jemi kanë të ftuar me një takim prej kryetari në atë takim nuk ka shkuar as kryetari i fshatit po u kanë vetëm Zeka edhe Florenti askush tjetër, për ngecjen e punëve për dallaveret që janë bë, që nuk është duke u kry puna hiq tash na aty me shkua me bë marrëveshje, nuk ka marrëveshje, është projekti le të kryhet puna mirë në bazë të projektit, le të jetë funksional ne e pranojmë, është komisioni i pranimit e kisha lut atë komision që mos të bëjë pranimin pa u kry puna mirë se do të ketë probleme edhe me prokurori, a për takimin që na ka thirr është kanë për mu merr vesh çka me ba me ato probleme, ajo nuk ka nevojë mu ndodh, është projekti le të kryhet ashtu.

Kryesuesi: Faleminderit Bekim, meqë na u bashkëngjitën në seancë edhe përfaqësuesit e OSBE-së po e shfrytëzoj rastin ti përshëndes.

z.Hasan Aliu: Mua po më vjen shumë keq Bekim se nuk po bëhesh i sinqertë, ai ka qenë një takim i progresit, nuk të kemi thirr për marrëveshje se marrëveshjen nuk mund me nënshkru ti si këshilltar i Kuvendit Komunal, se marrëveshjet dhe kontratat dihet kush i shkruan, por megjithatë e kemi pasur një varg ankesash në adresë të projektit dhe duhesh me pas të kuart se projekti diku 60% ka qenë i kryer, ne kur e kemi marrë qeverisjen këtë duhet ma pas të qartë dhe pjesa tjetër që ne e kemi vazhduar mangësi ndoshta ka edhe në fazën e parë ndoshta ka edhe në të dytën, unë nuk po du me prediku dhe takimi nuk ka qenë për marrëveshje, takimi ka qenë mu dëgjua zëri i arsyes dhe i qytetarëve të Smirës, mu dëgjua edhe i kompanisë, mu dëgjua edhe i komunës, a është duke u krye projekti në përputhje me atë i cili është projektua.

z.Daut Xhemajli: Dola ma shumë për këtë çështjen që po bisedohet, që sa e sa herë edhe unë mënoj se nuk është në rregull ta diskutojmë kaq shumë herë, sepse nëse është një çështje problematike, atëherë këshilltari ka të drejtë me marrë informata të sakta dhe me gjyku drejtë, për me marrë informata ta sakta ose për me gjyku drejtë për këtë çështje duhet me një formë gjithë këshilltaret me pas qasje, na kemi dëgjuar gjithçka rreth këtij projekti po qasje në letër nuk kemi, me pas kërkua Bekim ngritjen e një komisioni prej këtij Kuvendi me shqyrtua këtë çështje në gjitha aspektet edhe me dal para këtij kuvendi me na informu çka është ajo çështje edhe me diskutua apo me një formë me marrë mendim ka me orientu këtë çështje unë të kisha dhanë plotësisht të drejtë, po për çështjen e atyre mjeteve që nuk janë harxhu, unë mënoj se është tepër, se po bisedojmë për diçka që ndoshta është mirë një veprim që është bërë që nuk kanë shku edhe ato mjete, se paskemi pas me shku gabim, po supozoj këtë, por drejtori është i obliguar me thanë, në bazë të nenit kaq kaq të këtij ligji kryetari i komunës ka obligim ose drejtë mi orientu mjetet që janë të zotuar e që nuk harxhohen në fund të vitit.

z.Bislim Bislimaj: Ma merr mendja se është në dobi të gjithëve, ma së tepërmi për ata fëmijë që mund me pësu, unë e kisha dhënë një propozim që të shikojmë se si i kanë zgjidh komunat tjera, p.sh.: në Prishtinë është ajo zebra e gjatë e policit të shtrirë 2,5 metra, atë Shpendi si u ardhur në pushtet e ka bë edhe ne mundemi me bë, nuk është kjo ndonjë fshehtësi as nuk është ndonjë poen politik që mundem me fitu po është shumë e lirë dhe shumë e sigurt .

Kryesuesi: Faleminderit Bislim! idetë e qëlluara gjithherë duhet të përkrahen, pavarësisht a është pozitë apo opozitë, vetëm duhet mi shiku mundësitë materiale a janë, se për ndryshe ideja është e qëlluar. Unën ju falënderoj të gjithëve që dhatë kontribut rrethe pyetjeve dhe propozimeve, natyrisht për këtë seancë kemi paraparë këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Kuvendit Komunal të Vitisë.
2. Propozim vendimi për dhënien e pëlqimit kompanisë private “Bleta” SHPK për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën e gjeologjisë.
3. Propozim Rregullore për hapjen e kutive të ankesave.
4. Informatë e kontratave të nënshkruara për vitin 2015.

A ka dikush rrethe rendit të ditës diçka?, nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim. Konstatoj se me vota unanime miratohet rendi i ditës.

Si pikë të par të rendit të ditës kemi :

1. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa

A ka dikush rrethe pikës së par të rendit të ditës?, urdhëro.

znj.Mirlinda Sadiku: Nuk kapem për cikrime, mirëpo megjithatë më është hekur një fjali e tërë këtu kur e kam bë propozimin, atë petitionin që e kam prezentu, këtu kam thanë në vazhdimësi pas fjalës Anamoravë kam thanë z.Dauti, pasi vjen nga ai lokalitet mund ta jep kontributin e tij në këtë drejtim, komplet ajo fjali më është hekë.

Kryesuesi: Ne duhet të kemi parasysh se duhet të merret esenca e procesverbalit dhe nuk është e mundur që të inkorporohen të gjitha fjalët të cilat thuhën këtu në kuvend. Dikush tjetër a ka ju lutem, nëse nuk ka e hedhim në votim për miratim. Kush është që të miratohet kjo pikë? Konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të dytë kemi:

2. Propozim vendimi për dhënien e pëlqimit kompanisë private “ Bleta” SHPK për hulumtim dhe shfrytëzim në fushën e gjeologjisë

Ja kisha dhanë fjalën drejtorit.

z.Ibrahim Rama: Një ndërmarrje private ka idenë që të bëjë disa gjurmime në fushën e gjeologjisë dhe ajo me një shkresë dhe me një program që ka punu në këtë drejtim ju ka drejtua Kuvendit Komunal apo përmes Kuvendit Komunal neve Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim dhe ne e kemi analizuar këtë projekt të kësaj kompanie private e quajtur me emër “Bleta” nga Remniku, me përfaqësues Aqif Ibrahim, dhe si zakonisht e drejtë ekskluzive është e Kuvendit Komunal, që të këtë të drejtën për ti dhanë përkrahje zhvillimit të biznesit, sektorit privat, që t’i a japim një pëlqim për me fillua me procedurat për marrjen e lejes për hulumtime gjeologjike në pjesën e epërme të Visoçës, për këtë arsye edhe ne e kemi përgatitur këtë propozim vendim, materialin e keni marrë me kohë për pyetje përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi: Hapim debat rrethe kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merrni fjalën ju lutem?

z.Visar Demiri: Drejtori e shpjegoj pak ma mirë këtë në ekspozë që është vetëm një pëlqim, unë kam do vërejtje te propozim vendimi, gjithashtu edhe te kërkesa e kompanisë, neni 2 thotë: “pronarit të kompanisë i jepet pëlqimi për hulumtim dhe shfrytëzim”. E përmendi drejtori Ligjin për Financa dhe Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, po ashtu edhe Ligjin për Miniera dhe Minerale, që e rregullon këtë lëmi, nuk përmend hiq. Në bazë të këtij ligji licenca ose lejet janë disa leje, p.sh.: për hulumtim është e ndryshme për shfrytëzim është tjetër. Kjo kompani nëse ka kërkuar leje për hulumtim, atëherë të jetë te neni 2 pëlqimi për hulumtim jo dhe shfrytëzim. Te ministria kompetente, nuk lëshojnë ministritë leje, nuk mund me apliku në

ministri po te komisioni i pavarur për minerale dhe miniera, do me than është agjenci edhe këtu duhet të rregullohet kjo. Te kërkesa e kompanisë i drejtohem Kuvendit Komunal të Vitisë për dhënien e pëlqimit për të hulumtuar oksidin e kaliumin në vendin e quajtur Visoqa, unë besoj se duhet të jetë për dhënien e pëlqimit për aplikim pran KPMM-së dhe është kontradiktore në shumë vende, se sa kam pa unë se kjo është tu dashtë me hulumtu, me këtë pëlqimin tonë apo do me apliku në komision, këtu diku thotë: “nëse rezultatet edhe nga gjeofizika do të dalin për potencial mineral, atëherë projektmenaxheri do të siguroj leje për qasje nga komuna përkatëse dhe pronaret e tokave menaxheri i shpimeve do të koordinoj të gjitha aktivitetet, punët e infrastrukturës për qasjen në zonën e shpimit, d.m.th askund nuk e përmend se do të kërkoj leje pran komisionit, kjo është shumë kontradiktore, se ai së pari duhet me shku në komision me aplikua me marr leje, pastaj me fillu hulumtimi, tjetra nuk pajtohem me kohen gjashtë muaj, është shumë pak, se aq kohë i merr procedura e aplikimit në komision.

z.Bislim Bislimaj: Ne si lëvizje në parim jemi që me bë hulumtime po edhe ne konsiderojmë se procedura është e ngutshme, konsideroj se kompania duhet të ketë liçencim për hulumtime, që jepet nga këshilli i komisionit për miniera dhe minerale. Informatat të cilat duhet ti posedojmë ne janë: cilat janë kapacitet e kësaj kompanie për ndërmarrje të tillë, sa e ka stafin profesional, cila është kostoja, me çfarë mjete dhe nga i merr ato mjete që ti bëjë këto hulumtime, shqetësimi ynë bazohet në përvojën e hidhur të këtij kuvendi, kur e dimë se kemi dhanë një pëlqim për fizibilitet të digës, janë dhanë edhe do mjete prej komune afro 60 mijë euro sa di unë dhe shkuan ato pare, as nuk ka fizibilitet as asgjë hiq, vetëm mos të ndodh kjo se për ndryshe ne jemi pro.

Kryesuesi: Faleminderit z.Bislim, po të njoftoj se ky kuvend nuk e ka dhënë lejen, e ka dhënë një kuvend i kaluar lejen, se ky u konstitua në vitin 2014, dhe konsideroj se na si kuvend mos ti ndalimi këto iniciativa dhe nëse ai zotëria nuk është i kompletuar sigurisht ministritë përkatëse nuk do ti a japin lejen për shfrytëzim as për hulumtim. Shfrytëzoj rastin, pasi erdhi kryetari, ta përshëndes për prezencën e tij në punimet e kësaj seance.

z.Daut Xhemajli: Unë edhe në KPF kam fol rreth kësaj edhe nuk ka përmirësime, dhe për ata edhe dola edhe një herë. Problemi është që ne japim vetëm pëlqim si komunë për hulumtim edhe shfrytëzim a gjitha procedurat tjera mbikëqyren nga KPMM-ja, prandaj unë mendoj që ku e përmendi Visari, na nuk ka nevojë me dhënë për hulumtim a shfrytëzim, se si të i japim leje ai dihet hulumtimet i bënë edhe për me shfrytëzu, unë jam interesu, është krejt procedurë e KPM-së që ta udhëheq pastaj proceduarën dhe për licencën për hulumtim edhe për shfrytëzim, do me thanë përveç afatit që sipas meje është shumë kontestues dhe s’kemi nevojë ne mu thirr në afat se e përcakton KPMM-ja, atje thotë në ligj të komisionit me të cilën ata punojnë ma së paku 2-3 vjet, për disa minerale është 2 e për disa 3, problemi është që unë mendoj që edhe propozoj që ky afat për ne nuk ka nevojë të përcaktohet në këtë vendim, na japim pëlqim dhe na kur kemi thanë pranë ministrisë përkatëse, unë mendoj se duhet me thanë pranë organit kompetent dhe ky vendim prej pikës e këndeje unë mendoj se duhet me u fshi, sepse na nuk kemi nevojë gjashtë muaj, sepse krejt procedura kalon te komisioni dhe na nuk kemi nevojë më as me mbikëqyrë edhe nuk kemi kompetencë apo përgjegjësi ligjore.

z.Bislim Bislimaj: Ato informata z.Daut nuk janë që po na vyen ne për çka, por ne po dom me njohë kompaninë a është serioze apo nuk është, dhe desha me përmirësu atë ma herët, unë thash kuvendi si institucion ja ka dhënë lejen e jo ky kuvend, edhe kompania ka qenë apo nuk ka qenë inekzistente e ka regjistru, sot ka bë kërkesë në komunë ka marrë paret ka shkua dhe më pas kryetari i komunës është hedh në gjyq, se ne e dimë që ka ndodh diçka, se ka qenë edhe në mediat publike ajo, janë shkua 60 mijë euro, për atë thash se atëherë kompania nuk ka qenë serioze, prandaj na duhet me ditë kjo kompani a është serioze a jo.

z.Daut Xhemajli: Problemi është që na këtë kompani nuk ka nevojë me shti në filtra, sepse është përgjegjësi e kompanisë, që është e regjistruar, është e autorizuar për këtë, a e realizon a nuk e realizon nuk e di, ajo pretendimet e ka mi bë këto hulumtime, nëse i bënë për veti i ka, nëse ka mjete, se këtu është 400 mijë euro investime, këto mjete komuna nuk i jep për dallim prej atyre që e përmende ti që komuna ka pagu edhe kurrë nuk ka marr letra, por mbi të gjitha kjo nuk ka të bëjë fare me çështjen, për atë pendën a çështje tjera, ka të bëjë me atë se një kompani e komunës sonë është e interesuar në këtë fushë me investu dhe na japim pëlqim që ta filloj këtë aktivitet për mi bë këto hulumtime, unë jam dakord.

Kryesuesi: Meqë kryetarin e kemi këtu do ja kisha dhanë fjalën.

z.Sokol Haliti: Atëherë pasi tha edhe kryesuesi, unë ju përshëndes të gjithëve, detyrimet e tona si komunë dhe si kuvend është me rëndësi ne ti kryem, besoj se jeni dakord, gjithë ne të krijojmë ambient të biznesit, ambient progresi, ambient gjenerimi dhe zhvillimi ekonomik ajo është e rëndësishme. Po në këtë kuptim nuk është e rëndësishme të krijojmë ambient dhe të shkelmi rregullat dhe ligje, të krijojmë ambient të biznesit në kuadër të rregullave dhe ligjeve në fuqi, si komunë shquhemi për punë të mirë që kemi dhe kemi vullnet që të krijojmë ambient biznesi, prandaj duhet të krijojmë edhe në këtë kuptim. Në këtë kuptim ne do të jemi vigjilent jo vetëm me këtë edhe me ata që ju kemi dhënë pëlqime ma herët, do ta shikojmë bashkërisht, se jo kuvendi e ka të drejtën me shiku vërtetë a është duke u punuar me përgjegjshmëri edhe me efektivitet në mënyrë që kjo të ketë, ndërsa për aspekte të tjera të kuvendeve të kaluara unë nuk kisha hy me fol.

z.Ibrahim Rama: Gjatë përpilimit të këtij propozim vendimi, ku është fjala, te vërejtja për tjerat mos mi duplifiku përgjigjet, saktësia është për dhënien e lejes nga organet e nivelit qendrorë, na këtu nuk kemi dilemë se është ashtu, përndryshe ne si komunë ja japim vetëm pëlqimin, që ajo mbasandaj të jepi pëlqimin për atë në ministrin përkatëse. Sa i përket nenit 3, edhe aty ceket kush është përgjegjës për dhënien e lejes, atë që e kemi cek në fund është kanë se vendimet duhet me pas një afat kohorë për mos me pengu, në mënyrën në vijim dhe kohen në vijim që dikush tjetër ta bëjë një propozim apo kërkesë të natyrës së tillë, për këtë ne e kemi bë që mi përshpejtua procedurat, që me bë hulumtime në këtë pjesë të territorit të Komunës së Vitisë.

Kryesuesi: Besoj se e shterëm këtë pikë të rendit të ditës, me vërejtje e dhëna e qes në votim për miratim: Kush është që të miratohet kjo pikë e rendit të ditës? Konstatohet se me dy abstenime kalon kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi

3. Propozim Rregullorë për hapjen e kutive të ankesave

Ja kisha dhënë fjalën drejtorit të Administratës rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Isak Sadiku: Në mbështetje të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12,2 pika c dhe nenit 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008, neni 2 të Ligjit Nr. 03 /L-2015, mbi qasjen e dokumenteve publike dhe nenit 35.2 shkronja a të statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në seancë propozon këtë propozim Rregullorë. Materialin e keni marrë me kohë, vërejtjet që i kemi bë në KPF janë përmirësuar dhe besoj që ka ardhur e kompletuar në Kuvend. Për pyetje apo sqarime jam në dispozicion tu ndihmojë.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor! Hapim debat rreth kësaj pike të rendit të ditës: A donë ta merr fjalën dikush ju lutem?

z.Baki Nebiu: Është mirë që administrata ta ketë një kësi lloj rregullore, po ajo që dola me përmend është që në rregulloren që na i keni sjell në KPF na ka ufriu që anëtar i komisionit me qenë një anëtar edhe nga kuvendi i komunës, kurse në kuvend anëtar i komisionit prej kuvendi është larguar, dua arsye pse është larguar dhe unë kërkoj mu kanë një anëtar i kuvendit në këtë komision, pasi konsideroj që është në të mirë të kuvendit që të jetë sa ma afër anketueseve.

z.Ali Bajrami: Kjo rregullore që na ka ardhur sot për miratim duhet përhëndetur, se është një rregullore që i ka munguar Kuvendit Komunal të Vitisë, me vet rregulloren që do ta kemi në dispozicion besoj se do na shërbej për rritjen e transparencës për stafin e administratës dhe punëtorëve të kuvendit komunal. Ato qa u ceken këtu janë të përfshira dhe të harmonizuara me ligj. Isha ndal te neni 4, është mirë që komisioni që është i përbërë prej 5 anëtarëve është edhe shoqëria civile, po është edhe barazia gjinore. Te neni 5, që është për tu përhëndetur te pika 5,4, komisioni pas hapjes së kutive do ta ruaj dhe do ta mbroj anonimitetin e personave të përfshirë, dhe isha lidh me këtë te neni 7, ku është 7.4, asnjë vendim administrativ nuk mund të ndërmerret në dëm të parashtruesit të ankesës si pasoj e parashtrimit të ankesës, prandaj të gjitha këto janë se me një mënyrë neve na japin qasje të shohim se çka është duke u punuar në atë staf të punëtorëve që punojnë pranë administratës së Kuvendit Komunal.

z.Samet Idrizi: Grupi i PDK-së këtë propozim rregullore për hapjen e kutive të ankesave dhe vend vendosjen e tyre e she si diçka të mirë, si iniciativë të qëlluar, mendojmë se do të rritë cilësinë dhe transparencën deri diku, megjithatë shpresojmë të mos jetë si kuti ku dikush me qëllim me atakua dikë tjetër çoftë shërbyesit civil apo drejtorin apo këshilltarin, po të jetë në shërbim të transparencës dhe vlerësimit real të kritikës reale të kujdo qoftë që punon në komunë, andaj ne si grup e përkrahim këtë propozim rregullore.

z.Daut Xhemajli: Rreth kësaj kemi diskutuar edhe në KPF, po atje i kemi pasur dy versione, një që na ka ardhur edhe një i korrigjuar, prandaj ka pas mundësi me pas moskuptime, por prej këtij versioni që e kemi unë mendoj se duhet të ketë një korrigjim, sepse sidomos kutia të ankesave ka pas çdo herë, po është një rregullore që e rregullon këtë punë ta kemi parasysht dhe është një shans që i jepet qytetarëve me bë vërejtje pa u ditë adresa edhe pa u identifiku, unë mendoj se neni 7.2 duhet me u hekë se komisioni pas shqyrtimit të ankesave, sugjerimeve vërejtjeve obligohet që në afat ligjor të kthej përgjigje me shkrim, 7.1 është komisioni brenda tri dite është i obliguar me hartua raport për ankesat edhe ato ankesa i dorëzon drejtorit për Administratë, nëse ja dorëzon drejtorit komisioni ma nuk ka punë me bë përgjigje në ankesa etj, siç është thanë në nenin 7.2, prandaj 7.2-shi duhet me u fshi, sepse ata që bëjnë vërejtje në këto kutia kryesisht nuk kanë adresë, se ata kanë me thanë p.sh filan punëtori nuk gjendet në vend të punës, filan punëtori ka kërkuar mito etj, etj, na përgjigje nuk kemi nevojë me ju dhanë, na kemi nevojë si administratë me reflektu karshi këtyre vërejtjeve edhe mi pas parasysht sjelljet e punëtorëve eventualisht gjatë mbikëqyrjes me marrë masa ose edhe me sanksionu atë sjellje të keqe, se përndryshe se ka thënë dikush anonimisht se dikush është sjell keq na nuk mundemi me i kthye përgjigje, edhe duhet me pas parasysht se mund të ketë ankesa të porositura me prapavi, tendenca, na nuk mundemi me reflektu krejt karshi atyre ankesave, por stafi udhëheqës i ka parasysht ato qa ka than për një njeri të caktuar edhe e mbikëqyrë, e vëzhgon a janë apo nuk janë ato a qëndrojnë ato apo jo e pastaj m'bazë të veprimeve që mund me i gjetur mund me fillu me procedurat tjera. Prandaj, unë mendoj se 7.2 si nen të hiqet e këto tjerat mendoj se janë mirë.

z.Bislim Bislimaj: Meqenëse nuk e di se sa mbushen ato, po tu e ditë mentalitetin dhe popullin tonë se nuk mund me bë diçka me ato kutia, tash po më duket se edhe ne këshilltaret komunal jemi në dilemë se pse vendosen ato kutia, nëse vendosen për me u ankua me bë ankesë për ndonjë keqpërdorim apo ndonjë ngacmim dikush duhet me përcjellë, ai person

çfarë ngacmime bënë çfarë vepra të këqija bënë edhe me përcjell edhe me dërgu te organet hetuese, nëse na vetëm i marrim i lexojmë edhe prapë i qesim ajo nuk ka efekt, prandaj edhe populli nuk ka kulturë për me shkru një ankesë ndaj saj, pra këtë kuti e ka prua demokracia se në kohë të komunizmit nuk ka pasur kesi kutia.

Kryesuesi: Faleminderit z.Bislim, na nuk mund të themi se populli janë i pa kulturuar, populli është i kulturuar dhe natyrisht kërkesat apo ankesat të cilat nuk kanë janë në nivel komisioni do ti mënjanoj dhe nuk do ti shqyrtoj fare, por sidoqoftë unë konsideroj se është një rregullore se ja vlen si komunë ne me pas dhe besoj se po e bëjmë një hap të mirë, se qytetaret mund ti adresojnë në formë anonime kërkesat për shqetësime e tyre në lidhje me stafin.

z.Nuredin Lutfiu: Desha të kyçem këtu te komisioni për hapjen e kutive, pika 5 alinea 4 do të thotë duke mbajtur anonimitetin e personit të përfshirë, nëse tha se duhet mbajtur anonimitetin këtu te neni 6 duhet të futet që asnjë ankesë e cila nuk e ka emrin edhe mbiemrin mos të shqyrtohet, sepse ankuesi duhet me qenë me emër dhe mbiemër, se aty tani mund me pas qëllime, për mos me pas qëllime duhet të jetë me emër dhe mbiemër ankuesi.

z.Hasan Aliu: Unë fillimisht do të bëjë përpjekje së bashku me të gjithë koleget me dhënë rolin e kutive, ata të cilit marrin përgjigje me shkrim, që nuk ju ka njoft një e drejtë, ata e kanë udhëzimin administrativ e kanë udhëzimin mbi mjetin juridik edhe ushtrojnë ankesë me emër dhe mbiemër, po mos të harrojmë në komunë nuk janë krejt çështje administrative, kryen disa edhe veprim administrativ, p.sh.: shkon e kërkon një certifikat të lindjes dhe ai nuk ja refuzon me vendim mi than ty nuk të takon dhe nuk ka rrugë tjetër ai përveç ankesës së kutive apo janë shumë çështje tjera. Në këtë drejtim është edhe një lëmi, është edhe një fushë të cilën çdo qytetari e ka të drejtën e vet që mund edhe me emër me mbiemër aty me dal. Kutia e ankesave do ti ndihmon shumë të gjithë drejtorëve të drejtorive në përcjelljen e stafit se si janë në raport me palët në funksionim të kryerjes së shërbimit. Çështjen që e shtroi Baku është e vërtetë, po më duket e kam shpjegu edhe në KPF atë, se të njëjtën ditë e kemi shpërnda edhe për Bord të Drejtorëve edhe për anëtarë të KPF-së, prandaj është përvjedh ai gabimi, ne kemi dashtë me nda ekzekutivin prej kuvendi, se këtu bëhet fjalë për shërbyes civil.

z.Adnan Ymeri: Disa vërejtje ishin shumë të arsyeshme, mirëpo këtë parimisht unë kisha quajtur këtë propozim rregullore për hapjen e kutive të vërejtjeve për arsye se personat në këtë kuti mundin vetëm vërejtje të paraqesin, te e drejta e ankesës do ti shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike, së pari duhet për një çështje të paraqesim kërkesë, nëse ndaj asaj kërkesë institucioni kompetent na drejtohet me vendim, i cili vendim duhet ta ketë edhe mjetin juridik, të drejtën e ankesës dhe të mund të paraqesim ankesë kundër atij vendimi, që na i kthen institucioni. Tash nëse e shini të arsyeshme mund ta ndryshojmë nëse jo vazhdojmë, ndërsa te pika 7,4 neni 117 asnjë vendim administrativ nuk do të merret në dëm të parashtruesit të ankesës, është e drejtë fundamentale që parashihet me konventat ndërkombëtare, që çdo njeri mund të paraqes ankesë dhe asnjë vendim nuk mund të merret në dëm të tij.

Kryesuesi: Meqenëse kjo rregullore nuk është paraparë me dal në debat publik, sepse i përcakton rregullimin e brendshëm të komunës, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin e dhënë dhe e hodhi në votim për miratim këtë rregullore me vërejtjet që u dhanë: Kush është që të miratohet kjo rregullore? Konstatoj se me votat e të gjithë të pranishmëve miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, dhe si pikë të fundit të rendit të ditës kemi:

4. Informatë e kontratave të nënshkruara për periudhën janar – shtatorë të vitit 2015

Ftoj zyrtarin e prokurimit që ta merr fjalën rrethe kësaj informate.

Z. Fadil Abazi: Na e kemi qu si informatë ashtu si na i keni kërkuar edhe i kemi bashkangjitur raportin e kontratave, d.m.th esencialisht e kemi përmbledhë gjithë aktivitetin që i kemi kryer gjatë këtyre 9 muajve. Gjatë 9 muajve janë kryer 63 aktivitete të prokurimit, prej të cilave d.m.th i ndajmë në shërbime. mallra edhe në furnizime, 20 aktivitete janë lëndë shërbime, 17 aktivitete janë lëndë prokurimi punë, 26 janë lëndë prokurimi furnizime. Bazuar në këto statistika Zyra Prokurimit, duke analizuar me planifikimin zyra jonë ka realizuar planin për 75%, mirëpo nëse e shikojmë mirë planin sipas aktiviteteve si i kemi planifikua na për 2015 me numra, del që i kemi realizua planin 100%, mirëpo këtu kanë hy disa aktivitete që nuk janë paraparë, që zakonisht na ndodh d.m.th kemi përdor edhe aktivitete të paplanifikuara. Mos të ju marrë ma shumë kohë, jam në dispozicion për ndonjë pyetje apo ndonjë sugjerim.

Kryesuesi: Hapim debat rrethë kësaj pike: A donë ta merre fjalën dikush ju lutem?

z.Bekim Azizi: Mirë është që na ka ardhur kjo informatë, informata është vetëm për kontratat e shkruara, unë e kisha pyetur: A ka pasur ankesa gjatë tenderimeve, sa procedura janë përsëritur ose janë anulua?, ndoshta na i jep një informatë. Shohë se shumica e projekteve janë në nën 10 mijë euro vlera, që mendoj se janë shkelje të ligjit në disa raste ato se janë nën 10 mijë euro, e dimë se nuk lejojnë me procedura të hapura dhe me 3 oferta ato shkojnë janë të përgatitura mirë janë, rasti të hartimit të projekteve, d.m.th aty janë të vërejtura se ka shkelje, ka në disa raste konflikt të interesit, që shihet konkretisht këtu te kontratat me 12.01.2015 ditat, furnizim me ditat për shkollat në janar, çfarë ditare janë ble, ndoshta na i jep një informatë, edhe në kontratë këtu e kemi 06.07.2015, rregullimi i parkut te emergjenca edhe te "Lidhja Prizrenit", unë e kam ngrit këtë çështje në maj, që nuk janë pagu punët që janë kry në vitin 2014, reagoj shumë ashpër edhe kryetari edhe drejtori i Financave, që më erdhi keq se reagoi, se mua ai i kompanisë më tha që nuk mi kanë dhënë parat, e tash po e shoh se në vitin 2014 është krye puna, në 2015 lidhet kontrata për mu krye ai projekt, plus asaj kontrata nuk lidhet me firmën që e ka krye e merr një firmë tjetër, unë e kisha kërkuar në këtë kontratë me ma sjell mua prej Zyrës së Prokurimit, besoj se ma sjellin.

z.Sejdi Emini: Faleminderit! Shumicën i tha Bekimi, të njëjtin send nuk do ta përsërisë, po për mua kjo listë nënkupton se financuesit e fushatës po marrin tendera, shumë njerëz që e dimë që e kanë financua fushatën e juaj sot i shpërbleni me tendera, edhe ma shqetësuese është cilësia e këtyre projekteve, punët që kryen duhet me u krye me standarde, ka disa rrugë që po asfaltohen edhe këtë vit po me një standard që besoj që nuk është duke i plotësuar kushtet, 3.5 metra asfalt mu kanë për një kaheje bënë ama për dy kaheje dy makina me kalua nuk bënë. Ma mirë kishte me qenë që nëse jeni duke i kry 30 projekte mu krye 20 këtë vite, po krye me standarde qysh e lyp standardi, se prapë është kosto të njëjtën punë besoni ka me lind nevoja që pas pak dite ose pas pak kohe me krye. Kështu që ju kisha bë apel mos të bëjnë atë punë vetëm sa për sy e faqe po të bëjnë atë punë afatgjate edhe le të ja vlen me bë. Edhe një send, drejtoret shkuan po unë po shoh këtu person që ka dy tri firma të regjistruara dhe i njëjti konkurren me dy tri firma, ka qenë ai debati me drejtorin e Arsimit kur kam thanë se topat 60 euro, ai ka thanë se janë tri kompani, por një person po i ka tri kompani dhe tash i njëjti konkurren me vëllaun me motrën edhe i njëjti e merr, ky është shqetësim që me të vërtetë duhet me pas kujdes.

znj.Mirlinda Sadiku: Do të ishte mirë të përgjigjet drejtori i Arsimit, po në mungesë të tij ndoshta edhe nënkryetari. Këtu e kemi te faqja e fundit, transporti i nxënësve në relacionin Viti - Potgorc, Viti - Samakovë, Stubell – Letnicë, gogja një shumë e madhe, 4 mijë për Stubell-Letnicë , 5600 për Vit – Samakovë, kur e dimë se Samakova nuk është fshat që është në kuadër të Vitisë si dhe kemi Viti - Podgorc 3500 euro, ndërsa me sa di unë transporti për nxënës e Debëlldeut e keni ndërpre, atëherë pse.

z.Samet Idrizi: Atëherë një informatë mbi kontratat e nënshkruara në vitin 2015 e kërkuar nga Bekimi, normal kjo është kërkuar si informatë dhe zyrtari i prokurimit e ka sjell në mënyrë jo të plotë, mirëpo këtu bukur shumë ka të dhëna që sqarojnë procedurën edhe atë se a është tu respektua Ligi i Prokurimit a jo. Nisemi nga 63 aktivitete të prokurimit, duke i përfshirë edhe ato shifra të vogla, që janë 42 prej tyre janë bërë pa tender të hapur publik, vetëm 21 janë bërë me tender të hapur publik, ku diku 66% janë proceduar pa tender. Këtë kontratë pa tender ki mundësi me ja dhënë kujtdo qoftë se ta mundëson ligji, ligji ta mundëson nëse ti ke bërë ndarje publike dhe prapë e ke shkëlur ligjin. Kur të bëhet auditimi 2015 e shini ju se ata kanë mu thirr në ato ndarje të jashtëzakonshme të Ligjit të Prokurimit. Auditori i Brendshëm nuk mundet në mënyrë eksplicite me sqaru këtë detal, por nëse vinë ekspertet e KRPP-së ata e dinë saktësisht se ata i bëjnë këto udhëzime edhe këto rregullore, atëherë unë nuk e kisha fajësu komplet zyrtarin e Prokurimit, megjithëse edhe ky mban përgjegjësi për zhvillim të procedurës në këtë mënyrë, se aty te deklarata e nevojave dhe disponueshmëria e mjeteve e nënshkruan kryetari, drejtori i Financave dhe njësitë përkatëse që e inicon një shërbim, përnjëmend shqetësuese është, nuk di a mund me u kanë edhe me ndonjë komunë tjetër, që prej 63 kontratave 42 mu kanë pa tender është e tepërt, edhe unë pash se kemi një kompani që për një vit ka marrë dy punë, s'është në rregull. Unë pash se p.sh.: hartimi i projektit zbatues të kanalizimit në Ramnishtë, për shërbimet që nuk janë të gatshme në treg po që duhet të përpunohen duhet gjithësesi me pas tender të hapur. Tjetra, rregullimi i parqeve 9900 euro sa ke ajo është punë, ajo duhet me u tenderu gjithësesi, edhe këtu kemi dy raste të shërbimeve që s'janë tenderu, duhet me u tenderu edhe dy-tri punë tjera që duhet me u tenderu. Kontratat që kanë këto të vogla 920 euro, 300-400, mirë që i ka raportuar, por unë nuk kisha vepruar për to, s'janë shumë për kapacitetin e komunës. Tjetra, është mirë me pasur edhe planifikimin e prokurimit me krahasur tana edhe dinamikën e punës e kontratave, edhe për shembull aty planifikimi i sasisë monetare, e cila edhe njëherë rregullohet deklarata e nevojave, na nuk e dimë këtu janë të planifikuara 2 milionë e 569 mijë, por nuk e dimë tash sa janë shpenzuar, nashta janë 1 milionë e 900 mijë apo më shumë apo ma pak, por po mendoj që në fund të vitit ne kemi në janar apo shkurt me pranuar një raport gjithëpërfshirës të Zyrës së Prokurimit, ku do të bëjmë krahasimin, duke filluar prej planifikimit të prokurimit, deklaratave të nevojave dhe realizimit të kontratave veç e veç.

Kryesuesi: Faleminderit z.Samet! U shtruan një numër pyetjeve, unë kisha ftuar menaxherin e Zyrës së Prokurimit, që mundësisht të jap përgjigje në pyetjet e parashtruara.

z.Fadil Abazi. Nisim prej Sametit, prej fundit. Unë po mendoj, prita një pyetje konkrete, më duket se kështu kanë pak a shumë politike, me paragjykime, për cilat edhe s'mundem me dhanë përgjegje. Shembull, siç e thotë Sameti, e cakton paraprakisht fituesin kjo, ajo e merr, kërkuar ligji se ndalon kerkujna me i marr 10 tendera, si ti fiton me ligj veç duhet me e shti në konkurrencë, ti e din këtë punë mirë edhe nëse paragjykon ti koutimin e çmimit si një tender ajo është formë e procedurës ligjore e cila lejohet me u përdor dhe kurrë nuk është shkelje, nuk mundemi me i thanë shkelje kur ajo është formë e procedurës ligjore, të cilën ti e përdor edhe atë ta cakton jo unë, as menaxhmenti i jem, as kerkush, por e cakton ligji, domethënë ta bjen paramasën 9000 euro, ti s'mundesh me qit në publik, qoje ti një punë me 10 mijë euro ta kthen, thotë ky është kuotim, mos ma qo se s'ta shpalli publik, mu ma kanë kthy edhe kam raste. Po të kallxoj ty e normal që ti mundesh vet me marr parasysh domethënë pse llogaritet kuotim, vlera e përcakton në formën e procedurës së kuotimit. Ndërsa në gjithë këto janë të bazume, se edhe Beka diçka inicioj, kështu domethënë e keni nenin 19 dhe 20 të Ligjit të Prokurimit Publik. Ju lutem mundeni me konsultu, e lexoni edhe aty shihen qartë domethënë qeto procedura përdoren dhe çfarë forme shkojnë, pse ato janë përdor është se ligji i lejon si të tilla dhe

absolutisht nuk mundemi me thanë se ka shkelje. Kjo është një praktikë që e përdorim, mundesh me dhanë ti një praktikë tjetër, nëse është shkelje e ligjit Samet, atëherë mundesh me ma caktu nenin, cilin nen të ligjit e kam shkelur unë përgjigje edhe përgjegjësi të jap. Ankesa, domethënë gjatë vitit, i kemi pasur dy ankesa, faktikisht të iniciuara janë kanë tri ose katra, por janë tërheq operatorët, ndërsa i kemi patur vetëm dy ankesa të cilat kanë shkuar në OSHP, që mendoj është një statistikë shumë e përmirësuar, duke pasur parasysh vitet e kaluara, është shumë ma e ulët, shumë ma e mirë, domethënë nuk kemi pasur ndonjë shkelje nga operatorët, nuk kanë shpreh interesim me u ankuar. Sa jeni të njoftuar, ditarët në shkollën e mesme teknike më duket janë vjedhur, gjimnaz, në njërin dikund janë vjedhur, veç e di e kemi iniciuar si procedurë, sepse ditarët janë vjedhur, kështu edhe aty e kemi iniciuar, kemi blerë ditar te rinj. Sa i përket parkut, aty kemi dy procedura, domethënë një e kemi pasur në 2014, që është kryer nga ana ka është parku tek ambulanta , ndërsa këtë tjetrën e kemi kryer sivjet që është ka emergjenca, domethënë e kemi pastruar atë pjesën poshtë, është ndërtuar emergjenca dhe është rregulluar një park i vogël, kemi pasur edhe shumë intervenime tjera.

Janë tri transporte që i bart nxënset, janë kontrata vjetore për 10 muaj, janë ato çmime, këto 3400 janë 340 për Podgorc , 570 është për Samakovë dhe kështu.

Kryesuesi: Urdhëro nënkryetar!

z.Hasan Aliu: U drejtua Mirlinda, është fjala pse tri lokalitete, barten nxënset dhe një nuk barten, këto kontrata janë të lidhura për bartjen e nxënsave prej klasës së 6-9, ndërsa Debelldehu ka kërkuar për nxënset e shkollës së mesme, prandaj në aspekt ligjor të lejon të barten këta, ndërsa për ata ka pengesë, ndërsa sa i përket Samakovës, a është me Kacanik a ka Vitia, aty janë disa shtëpi të cilat janë me Vitinë, por shkollën e ndjekin gjeneratë pas gjenerate ne territorin e Komunës së Vitisë. Ndërsa ajo që është ma shqetësuese është se konsideroj se këshilltarët e kuvendit komunal duhet ta ruajnë etikën, prejudikimet janë të këqija, ju keni dhanë operatorëve të cilët ua kanë ba fushatë, pse thua ashtu, ti e lëndon vetveten po të tregoj drejtë z.Sejda, sikur me ta shtruar pyetjen dikush prej këshilltarëve kush po iu financon juve me ditë të tëra që po rri te komuna atje, nashta është vullneti i juaji me prejudikuar, nuk ke të drejtë në radhë të parë, në rend të dytë nuk është etike një këshilltar i kuvendit komunal me prejudiku se çdo parti politike ka pasur fushatë, e ka bërë në formën e vet të organizimit, grumbullimit të atyre mjeteve nga anëtarët e partisë apo nga kushdo qoftë, por megjithatë shumë operator të cilët kanë pasur kontratën e tenderit edhe sot kanë vazhduar, që është shumë domethënëse, operatorët që kanë krijuar kushte ma të mira vazhdojnë edhe me i pas kontratat. Me prejudikuar në atë formë, unë besoj se nuk i kontribuon të mirës, por me pas vërejtje konkrete është diçka krejt tjetër. Po ndërtohen shumë rrugë, ty nashta të pengon pse 30 e nuk i kemi lanë 15, këto janë rrugë po thua jashtë standardit, ministria ka pasur projekt në fshatin tim dhe rrugët e lagjeve i ka shtruar 3 metra e gjysmë, nashta edhe ata kokan jashtë standardit, prandaj duhet të jemi shumë korrekt. Në rast se po të pengon pse 30 rrugë e jo 20 është diçka tjetër, mundesh me shtruar atë problematikë, por megjithatë tri e gjysmë nëpër lagje, unë konsideroj se është një prej formave që është aplikuar në nivel të Kosovës edhe nga ana e ministrisë edhe nga ana e komunës, por me dal foltore me fol çka të teket është diçka tjetër, mirëpo unë konsideroj se e kemi një obligim edhe ndaj qytetarëve edhe ndaj vetvetes.

Kryesuesi: Urdhëro z.Samet!

z.Samet Idrizi: Unë sinqerisht mundem me ardh edhe me nene, por seancën tjetër, unë po befasohem prej Fadilit qysh po mundet në këtë formë kaq të paskrupullt me thanë është gjithçka në rregull, kur 66% të aktiviteteve në masë i ka bërë pa prokurim, po s'është në rregull kjo, unë për vete 37% i kam pasur me ftesë për kuotim edhe kam marr vërejtje prej KRPP-së, ja kanë dhanë vëllaut të një drejtoreshës dy tendera ka 9900 euro, por unë s'ia la krejt fajin Fadilit

se e ka politikën përmas edhe unë nashta kisha ba qashtu, të bahemi fer, se s'është shkatërruar Vitia as s'është ba najfarë dëmi financiar i jashtëzakonshëm që ka me mbet dikush pa bukë po të bëhemi fer. Unë po them në mënyrën sa më profesionale të mundshme qysh ka mundësi 4 hartime të projekteve zbatuese me u nda e mos me u tenderuar përnjëherë, hartimi i projektit zbatues të shkollës fillore në fshatin Beguncë një 9900 euro, 2) hartimi i planit zbatues të kanalizimit në fshatin Ramnishtë, hartimi i projektit zbatues të rrugës Kllokot-Zhiti-Kllokot edhe hartimi i projektit zbatues të rrugës Viti-Mogillë 5500, të katërtat këto qiten bashkërisht, aty janë grupi i inxhinierave që punojnë, kanë firma tenderojnë, por për mos me i qit në tender u janë ndarë, por kjo është ndarje e madhe, katër here i kanë ndarë për nivel, por edhe kjo tjetra mundem me ardh edhe me nen specifik për këto i ka. Transporti i nxënësve, pse mos me qit një tender, por përshembull transporti i nxënësve në relacionin Viti-Podgorc 3500 euro e qesin në veti me ftesë për kuotim, se e kalon ia jep kujna duash, transporti i nxënësve Viti-Samakovë 5600 edhe tjetrin Stubëll-Letnicë, kur i mbledh këto trija bashkë e kalojnë 10 mijëshin, në momentin që e kalojnë 10 mijëshin duhesh me i qit në tender, kur e qet në tender s'di kush e merr, edhe për qeta këto sene bëhen edhe janë bërë, këto shihen prej aeroplanit s'ka nevojë me kanë i meqem me shku në shkollë apo fakultet apo trajnim për me e pa që s'është mirë. S'di qysh mundet me thanë Fadili s'ka ndarje, ndarja është shkelje edhe seancën tjetër hajde këtu ti bij nenet veç e veç pa asnjë problem.

Kryesuesi: Po Sejd, urdhëro!

z.Sejdi Emini: Nënkyetar, unë rrugën e lagjes tem e kam 3 metra e gjysmë, po të tregoj që nuk është rrugë standarde, se kur bijnë dy makina përballë njëra-tjetrës detyrohemi be me hi në lllagom njana me lëshu asfaltin, nëse ti e quan një rrugë standard që dy kahje nuk kanë vend me kalu nëpër asfalt, atëherë është problemi yt, por nuk jam tu e thanë atë që është mendimi veç i jemi, por ma kanë thanë edhe qytetarët e Kabashit, Pozhoranit, Radivojcit, krejt be janë tu e thanë edhe ti nuk e di pse po sjell dilema kur e din edhe vet kur shkon me veturë tanden e lëshon asfaltin edhe hin në lllagom, atëherë ai është problemi i yt. Për sa nuk jeni duke i shpërblyer militantët, ma bre mos e thuaj, mos na shtin me emra, me mbiemra, mu ba kare edhe na se i kemi koleg, jeni duke ju dhanë vëllezërve të drejtoreshave, jeni duke ju dhënë vëllazërive të asamblistëve, jeni duke ju dhënë shokëve, jaranave, krejt jeni duke i bërë, por mos e thuaj jo, heshte, na shtin veç me hy ma thellë, po hyjna, s'ka problem, deri ku të duash shkojmë, sendet janë reale.

Kryesuesi: Unë vij nga Pozherani dhe për ditë jam kontakt me qytetarët e Pozheranit dhe janë shumë falënderues për rrugën që jemi duke jua shtruar dhe të lutem nuk e di ku po i merr ti ato informata në Pozheran kur unë pij kafe për ditë, bile janë shumë falënderues edhe dreka po qesin, andaj të lutem mos dezinformo. Urdhëro z.Fadil!

z.Fadil Abazi: Unë prita pyetje konkrete, por nuk e prita praj Sametit, me dështu profesionalisht, me i paragyku sendet, që nuk ia ka kqyrë mirë ose s'po i njeh ose s'po i din. Unë ju kisha lut faqen e fundit të raportit tim të lexoni transportin e nxënësve e cila është 0,59 numri dhe aty e keni transportin e nxënësve në Samakovë, 221 është procedurë e hapur, Sameti e din, domethënë 2 është shërbim, 2 është vlere e mesme, 1 është procedurë e hapur, por Sameti nuk e ka lexuar, faktikisht unë e kam udhëhequr një procedurë të hapur edhe pse vlere e mallit është e vogël, por për shkak të transparencës. Konkretisht ti e dhe një informatë jo të saktë, domethënë sepse 0,59 është i përfshirë për tri herë, që do të thotë ajo është procedurë e hapur, shërbim numri 221.

Te hartimi i projekteve edhe këtu s'ke drejtë absolutisht se ato janë të ndara, por edhe kur ti qitësh në publik ke me i ndarë në llloto, sepse kanalizimi nuk shkon me ndërtim, nuk i kemi qit për shkak të arsyes, sepse na nuk i kemi qit gjithë projektet në hartim të projekteve, na i kemi

ndarë disa të cilat kanë qenë më komplekse dhe në interes me shkuar më shpejtë, tash katër domethënë krejt projektet tjera i kemi në zyra të projekteve, kështu që na me këtë metodë kemi arritur me përfitua në kohë dhe kemi përfituar në shpenzime. Jo ndarje, nuk janë ndarje, domethënë këto i lejon ligji, nëse ti thua se unë e kam ndarë, por kanalizimi nuk mundet me hy në të njëjtën procedurë me ndërtimin absolutisht, sepse ato janë të ndara vet, ndërsa sa i përket rruga Viti-Mogillë nuk korrespondon, se koha, hapësirë nuk takohen këto, sepse kur i kam kryer këto ajo nuk ka filuar ende, ndërsa projektet e tjera të mbetura po e marr shembull asfaltimi i rrugëve rurale, e cila është projekti ma kapital, sivjet diku rreth 400 mijë euro e ka kryer zyra e projekteve, ne aty si komunë kemi arritur me i shpëtu, së paku për hartim të projekteve, 25 mijë euro, pra, zyra e projekteve, e cila është duke u avanancuar tash me inxhiniera, me mjete, por me një të ardhme ka me kryer krejt, domethënë komuna në këtë drejtim po shkon rreth zvogëlimit së shpenzimeve për hartimin e projekteve. Ne i kemi bërë vetëm disa hartime të projekteve, ndërsa hartimi i rrugës Viti-Mogillë domethënë pasi janë kryer projektet e rrugëve e kemi memorandum me ministrinë me datën 14 mars, që do të thotë ato janë kryer me 14 prill.

Kryesuesi: Pasi kjo pikë nuk parashihet të votohet se është informatë, me kaq shpall të mbyllur këtë seancë. Mirupafshim në seancat e ardhshme!

Seanca përfundon punimet në ora 12 : 10

Procesmbajtës:

Ilir Zuka

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë

z.Naim Pira
